



**IP QENDRA E ARSIMIMIT TË TË RRITURVE - SHKUP**

***PROGRAMI***  
***i punës së IP Qendrës së Arsimimit të të Rriturve - Shkup 2023***

**Shkup, janar 2023**

## HYRJJE

Programi vjetor i punës së IP Qendrës së Arsimimit të të Rriturve - Shkup për vitin 2023 bazohet në kompetencat dhe detyrimet që burojnë nga Ligji i Arsimimit të të Rriturve edhe atë:

- kryen monitorimin, analizën dhe zhvillimin e sistemit të arsimit të të rriturve;
- punon në promovimin e arsimit dhe aftësimin të të rriturve në bashkëpunim me institucionet dhe institucionet për arsimimin e të rriturve;
- përgatit plane dhe programe mësimore për arsimin fillor, të mesëm dhe profesional të të rriturve, publikon katalogun e programeve të miratuara për arsimimin e të rriturve, përgatit standardet profesionale për programet e arsimit të të rriturve, verifikon programet e arsimit të të rriturve, përgatit një model të programeve publike të vlefshme për arsimimin e të rriturve;
- në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për punën inicion nevojën për hartimin e kualifikimeve të reja profesionale sipas standardeve;
- kryen punë profesionale, administrative për çështjet që vendos Këshilli i arsimit të të rriturve;
- kryen kërkime në fushën e arsimit të të rriturve;
- kryen punë këshillëdhënëse për kuadrin që zbaton programet e arsimit të të rriturve;
- përgatit standarde për pajisjet dhe kushtet hapësinore, si dhe për kompetencën e personelit të objekteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve;
- jep mendim për përmbushjen e standardeve të institucioneve që kërkojnë verifikim për realizimin e programeve të arsimit të të rriturve të njohura publikisht;
- jep një katalog të objekteve dhe institucioneve të verifikuara dhe të licencuara për arsimimin e të rriturve;
- organizon zhvillimin profesional dhe trajnimin e mësuesve dhe të trajnuesve;
- lidh arsimimin e të rriturve në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, dhe në pajtim me standardet dhe politikat e Bashkimit Europian;
- propozon masa për zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive të reja mësimore dhe zbatimin e tyre;
- bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale, Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Entin Shtetëror të Statistikave, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e arsimit të të rriturve, partnerët socialë dhe të tjera;
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Përcaktimi kryesor i këtij programi do të jetë përcaktimi i prioriteteve dhe realizimi i detyrave në drejtim të sigurimit të cilësisë dhe zhvillimit të arsimit të të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Prioritetet kryesore të IP Qendrës së Arsimimit të të Rriturve - Shkup (në tekstin e mëtejshëm: Qendra) për vitin 2023 janë:

- aktivitetet lidhur me përforcimin e kapaciteteve institucionale të Qendrës (ekipimi plotësues i kuadrit, pajisja teknike shtesë për funksionalitetin operativ të Qendrës);
- organizimi dhe realizimi i vazhdueshëm i trajnimeve me qëllim të përforcimit të kompetencave të punonjësve në Qendër;
- promovimi i arsimimit të të rriturve në kuadër të mësimit të përjetshëm dhe në IP Qendrën e Arsimimit të të rriturve - Shkup;
- mirëmbajtja e sistemit të informacionit (TIS) për ofruesit e shërbimeve dhe programeve të arsimimit për të rritur;
- hartimi i akteve nënligjore për vlefshmërinë e mësimit joformal dhe informal (VMJI);
- krijimi i sistemit të VMJI-së;
- përgatitja dhe zhvillimi i programeve mësimore për arsimimin e të rriturve;
- vazhdimi i organizimit të mësimdhënies konsultative - udhëzuese për formimin e arsimit të mesëm profesional në komunat: Prilep, Çair, Haraçinë, Saraj, Tetovë, Kumanovë dhe komunat e tjera ku paraqitet nevoja;
- verifikimi i programeve të arsimimit të të rriturve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve;
- mbikëqyrja e ekspertëve mbi punën e ofruesve të shërbimeve;
- realizimi i bashkëpunimit me partnerët socialë, me institucionet e arsimit të lartë dhe me aktorë të tjerë kryesorë;
- vendosja e kontakteve dhe e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, me qëllim zhvillimin e një orientimi evropian të arsimimit të të rriturve;
- sigurimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i zhvillimit të arsimimit të të rriturve me qëllim të harmonizimit të nevojave me zhvillimin modern, teknologjik dhe social.

Prioritetet e listuara janë të nevojshme për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe zhvillimin e arsimimit të të rriturve në kontekst të realizimit të suksesshëm dhe në kohë të masës së prioritetit të shtatë nga standardet për partneritet të qasshëm të dhëna nga Bashkimi Evropian.

Ky program paraqet një dokument të hapur dhe fleksibël në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të tij për të mundësuar qarkullimin e një numri më të madh informacionesh nga dhe drejt institucioneve arsimore dhe partnerëve socialë për mbështetjen dhe zhvillimin e mësimit të të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qëllime	Aktivitete	Bartës	Afati	Mjete financiare
PËRFORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË IP QENDRËS SË ARSIMIMIT TË TË RRITURVE	Ekipimi plotësues i kuadrit, a.sh. punësim Pajisja teknike shtesë me qëllim të sigurimit të funksionalitetit operativ të Qendrës.  Trajnimi i të punësuarve	IP Qendra e Arsimit të të Rriturve - Shkup	2023	Buxheti i QARR-it  Buxheti i QARR-it, projekte
PROMOVIMI I ARSIMIMIT TË TË RRITURVE DHE I IP QENDRËS SË ARSIMIMIT TË TË RRITURVE	Vizitë komunave, me qëllim të njohjes së aktiviteteve të Qendrës, veçanërisht në komunat ku nuk ka verifikim të programeve të veçanta	IP Qendra e të Rriturve - Shkup	2023	Buxheti i QARR-it, projekte
NPAA (PROGRAMI NACIONAL PËR HARMONIZIMIN E LEGJISLACIONIT VENDAS ME TË DREJTËN E BASHKIMIT EUROPIAN)	Planifikimi, hartimi dhe përditësimi i rregullt në NPAA-së sa i përket arsimimit të të rriturve	Spektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e sigurimit të cilësisë, e zhvillimit dhe e bashkëpunimit	Vijuese	Buxheti i QARR-it
PJESËMARRJE NË PUNËN E KOORDINATORËVE NACIONALË PËR ZBATIMIN E AGJENDËS EUROPIANE PËR ARSIMIMIN E TË RRITURVE	Pjesëmarrje në mbledhjet e rregullta dhe aktivitetet e koordinatorëve për zbatimin e Agjendës europiane për arsimimin e të rriturve	Spektori i avancimit të arsimimit të të rriturve	2023	Buxheti i QARR-it
KRIJIMI I SISTEMIT TË ZHVILLIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIMIT TË TË RRITURVE	- Përkufizimi i treguesve dhe i procedurave të cilësisë në arsimin e të rriturve	Spektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e sigurimit të cilësisë, e zhvillimit dhe e bashkëpunimit	2023	Buxheti i QARR-it  E4E, IPA
SIGURIMI I CILËSISË, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ARSIMIMIT TË TË RRITURVE	- Zhvillimi i instrumenteve dhe i mekanizmave për monitorimin dhe kontrollin e realizimit të arsimimit të të rriturve - Zhvillimi i mekanizmave dhe i instrumenteve për vlerësimin e ofruesve të arsimimit të të rriturve	Spektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e sigurimit të cilësisë, e zhvillimit dhe e bashkëpunimit	2023	Buxheti i QARR-it  E4E dhe IPA
PËRPILIMI I AKTEVE	Përpilimi i akteve nënligjore që burojnë nga Ligji i	Spektori i avancimit të arsimimit të të rriturve -	2023	Buxheti i QARR-it

NËNLIGJORE PËR VLEFSHMËRINË E MËSIMIT JOFORMAL DHE INFORMAL	Arsimimit të të Rriturve	Njësia e njohjes së mësimit paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit  Sektori i logjistikës - Njësia e çështjeve normativo-juridike, administrative dhe e mbështetjes informatike		
KRIJIMI I SISTEMIT TË VMJI-së	Me parashtrimin e ndryshimeve në Ligjin e Arsimit të të Rriturve dhe përpilimin e akteve nënligjore që burojnë nga Ligji, do të fillojë krijimi i sistemit të VMJI-së	Sektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e njohjes së mësimit paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit	2023	Buxheti i QARR-it, IPA
	Përgatitja e QRAPT-it për realizimin e procesit të vlefshmërisë së mësimit joformal dhe informal	Sektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e njohjes së mësimit paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit	2023	Buxheti i QARR-it, IPA
FORMIMI I ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL TË TË RRITURVE NË DISA KOMUNA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	Organizimi dhe monitorimi i procesit të formimit të arsimimit të mesëm profesional	IP Qendra e Arsimit të të Rriturve - Sektori i përgatitjes, i miratimit dhe i mbikëqyrjes profesionale të programeve arsimore të të rriturve - Njësia e përgatitjes dhe e miratimit të programeve	Vijues	Buxheti i QARR-it
ZHVILLIMI, VERIFIKIMI DHE REALIZIMI I PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË ARSIMIMIT TË TË RRITURVE	Verifikimi i programeve të arsimimit të të rriturve të cilat çojnë në kualifikime	IP Qendra e Arsimit të të Rriturve - Sektori i përgatitjes, i miratimit dhe i mbikëqyrjes profesionale të programeve arsimore të të rriturve - Njësia e përgatitjes dhe e miratimit të programeve	Vijues	Buxheti i QARR-it

	Verifikimi i programeve të cilat çojnë në njohuri, shkathtësi dhe kompetenca	Qendra e Arsimit të Rriturve - Sektori i avancimit të arsimit të rriturve - Njësia e njohjes së mësimi paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit	Vijues	Buxheti i QARR-it
PËRDITËSIMI DHE MIRËMBAJTJA E UEB FAQES DHE E BAZËS SË TË DHËNAVE TË IP QENDRËS SË ARSIMIMIT TË TË RRITURVE	Përditësimi i ueb faqes së QARR-it me shpallje dhe informacione të tjera për punën vijuese të QARR-it Ruajtja, organizimi (përditësimi), vendosja, si dhe shpërndarja e dokumenteve TI Mbështetja e të punësuarve, përpilimi i specifikimeve teknike dhe mirëmbajtja e pajisjes së TI-së	IP Qendra e Arsimit të Rriturve - Njësia e financave dhe punës materiale, punëve normativo-juridike dhe mbështetjes informatike	Vijues	Buxheti i QARR-it
	- Përditësimi i sistemit informativ (TIS) për ofruesit e shërbimeve dhe programeve të arsimit të rriturve	IP Qendra e Arsimit të Rriturve - Njësia e çështjeve normativo-juridike, administrative dhe e mbështetjes informatike	Vijues	Buxheti i QARR-it
MBIKËQYRJA PROFESIONALE E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE	Mbikëqyrje profesionale e ofruesve të shërbimeve të cilët kryejnë arsim formal	Sektori i përgatitjes, i miratimit dhe i mbikëqyrjes profesionale të arsimit të rriturve - Njësia e mbikëqyrjes profesionale dhe e vlerësimit	2023 viti	Buxheti i QARR-it
	Mbikëqyrje profesionale e ofruesve të shërbimeve të cilët kryejnë arsim joformal	Sektori i përgatitjes, i miratimit dhe i mbikëqyrjes profesionale të arsimit të rriturve - Njësia e mbikëqyrjes profesionale dhe e vlerësimit	2023 viti	Buxheti i QARR-it
	Bashkëpunimi i ofruesve të shërbimeve	Sektori i përgatitjes, i miratimit dhe i mbikëqyrjes profesionale të arsimit të rriturve - Njësia e mbikëqyrjes profesionale dhe e vlerësimit	2023 viti	Buxheti i QARR-it

## **PËRFORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË IP QENDRËS SË ARSIMIMIT TË TË RRRITURVE**

### ***Ekipimi plotësues i kuadrit, i ashtuquajtur punësim i kuadrit në Qendër***

Për shkak të mungesës së të punësuarve në IP Qendrën e Arsimit të të Rriturve, dhe me qëllim të realizimit të suksesshëm dhe efektiv, në vitin 2023 do të sigurojë kuadër shtesë, në pajtim me Rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës të Qendrës së Arsimit të të Rriturve, si dhe nëpërmjet të transferimit të kuadrit nga institucionet e tjera.

Afati: 2023

Bartës: IP Qendra e Arsimit të të Rriturve  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

### ***Pajisja teknike me qëllim të sigurimit të funksionalitetit operativ të Qendrës***

Për sapo të punësuarit në Qendër, do të ketë pajisje përkatëse shtesë dhe teknike kompjuterike, për sigurimin e funksionalitetit të tyre dhe sigurimin e kushteve për kryerjen e detyrave të përditshme.

Afati: 2023

Bartës: IP Qendra e Arsimit të të Rriturve  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **PROMOVIMI I ARSIMIMIT TË TË RRRITURVE DHE I IP QENDRËS SË ARSIMIMIT TË TË RRRITURVE**

Qendra e Arsimit të të Rriturve do të organizojë vizita në komunat me qëllim të promovimit të arsimit të të rriturve dhe mësimit gjatë gjithë jetës, si dhe njohjen e të gjithë faktorëve përkatës në arsimimin e të rriturve me aktivitetet e Qendrës së Arsimit të të Rriturve.

Afati: dhjetor 2023

Bartës: IP Qendra e Arsimit të të Rriturve  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it, projekte

## **NPAA (PROGRAMI NACIONAL I HARMONIZIMIT TË LEGJISLACIONIT VENDAS ME TË TË DREJTËN E BASHKIMIT EUROPIAN)**

Programi nacional i miratimit të së drejtës së Bashkimit European (NPAA) është dokument afatgjatë gjithëpërfshirës i cili e përkufizon dinamikën e miratimit të së

drejtës së BE-së, drejtimet strategjike, politikat, reformat, strukturat, burimet dhe afatet të cilat duhet të realizohen me qëllim të plotësimit të kushteve të anëtarësimit të Bashkimit Europian. Qendra e Arsimimit të të Rriturve i planifikon, përpilon dhe rregullisht i përditëson të dhënat e NPAA-së sa i përket arsimimit të të rriturve.

Afati: dhjetor 2023  
Bartës: IP Qendra e Arsimimit të të Rriturve  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **PJESËMARRJE NË PUNËN E KOORDINATORËVE NACIONALË PËR ZBATIMIN E AGJENDËS EUROPIANE TË TË RRRITURVE**

Qendra e Arsimimit të të Rriturve, si koordinator nacional i zbatimit të Agjendës europiane të arsimit të të rriturve, do të marrë pjesë në mbledhjet e rregullta dhe aktivitetet e koordinatorëve nacionalë.

Afati: dhjetor 2023  
Bartës: IP Qendra e Arsimimit të të Rriturve  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **KRIJIMI I SISTEMIT TË ZHVILLIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIMIT TË TË RRRITURVE**

Si pjesë e aktiviteteve të cilat burojnë nga Strategjia e arsimimit të të rriturve dhe krijimi i Sistemit të sigurimit të cilësisë së arsimimit të të rriturve. Në vitin 2023 Qendra e Arsimimit të të Rriturve do të fillojë aktivitetet lidhur me krijimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, edhe atë përkufizimin e treguesve dhe të procedurave për zhvillimin e cilësisë së arsimimit të të rriturve.

Gjithashtu do të punohet drejt zhvillimit të instrumenteve dhe të mekanizmave për monitorimin e realizimit të arsimimit të të rriturve, si dhe për vlerësimin ofruesve të shërbimeve.

Afati: 2023  
Bartës: Sektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e sigurimit të cilësisë, e zhvillimit dhe e bashkëpunimit  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it, E4E, IPA

## **PËRPILIMI I AKTEVE NËNLIGJORE PËR SISTEMIN E VLEFSHMËRISË SË MËSIMIT JOFORMAL DHE INFORMAL**

Në Ligjin e ri të Arsimimit të të Rriturve, parashihet shtimi i kreut të ri: Vlefshmëria e mësimi joformal dhe informal. Kjo shpie në nevojën e miratimit të një varg aktesh nënligjore të cilat do të jenë të domosdoshme për realizimin e sistemit të VMJI-së.

Afati: 2023



Bartës: Sektori i avancimit të arsimit të të rriturve, Njësia e njohjes së mësimit paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit; Sektori i logjistikës, Njësia e çështjeve normativo-juridike, administrative dhe e mbështetjes financiare  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **KRIJIMI I SISTEMIT TË VLEFSHMËRISË SË MËSIMIT JOFORMAL DHE INFORMAL**

Me miratimin e ndryshimeve të Ligjit të Arsimit të të Rriturve dhe përpilimin e akteve nënligjore të cilat burojnë nga Ligji, do të fillojë krijimi i sistemit.

Afati: 2023

Buxheti i QARR-it, i IPA-së

Bartës: Sektori i avancimit të arsimit të të rriturve - Njësia e njohjes së mësimit paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit

### ***Përgatitja e Qendrave rajonale të arsimit profesional dhe trajnimit (QRAPT) për realizimin e procesit të VMJ-së***

Me qëllim të zbatimit të suksesshëm të sistemit të VMJ-së në QRAPT, kuadri i QRAPT-it do të jetë i përgatitur për realizimin e sistemit të VMJ-së.

Afati: 2023

Buxheti i QARR-it, IPA-së

Bartës: Sektori i avancimit të arsimit të të rriturve - Njësia e njohjes së mësimit paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit

## **FORMIMI I ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL TË TË RRIURVE NË DISA KOMUNA**

Organizimi dhe monitorimi i mësimit konsultativ - udhëzues për formimin e arsimit të mesëm profesional për personat vetëm me arsim fillor. Mësimi do të realizohet në pajtim me planet mësimore dhe programet e arsimit të mesëm profesional në komunat Prilep, Çair, Haraçinë, Saraj, Tetovë, Kumanovë në të cilat vetëm se ka filluar mësimi, si dhe në komunat e reja në Republikën e Maqedonisë në të cilat do të ketë nevojë.

Afati: Vijues

Bartës: Njësia e përgatitjes dhe e miratimit të programeve  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **ZHVILLIMI, VERIFIKIMI DHE REALIZIMI I PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË ARSIMIT TË TË RRIURVE**

### ***Verifikimi i programeve të arsimimit të të rriturve të cilat çojnë në kualifikime***

Procesi i verifikimit të programeve të veçanta, i cili shpie në arritjen e kualifikimeve, një pjesë e kualifikimit ka për qëllim përforcimin e kompetencave kryesore për mësim gjatë gjithë jetës. Procesi i verifikimit të programeve të veçanta të parashtruara nga ana e ofruesve të shërbimeve vazhdon edhe në vitin 2023.

Afati: Vijues  
Bartës: Njësia e përgatitjes dhe e miratimit të programeve  
Mjete financiare: Provajderë për arsimimin e të rriturve

### ***Verifikimi i programeve të cilat çojnë në njohuri, shkathtësi dhe kompetenca***

Në vitin 2023 Qendra e Arsimimit të të Rriturve vazhdon me verifikimin e programeve që çojnë në njohuri, shkathtësi dhe kompetenca. Programet e këtilla u mundësojnë kandidatëve të marrin njohuri, shkathtësi dhe kompetenca që do t'i përdornin në korniza të punës së tyre. Njëpërmjet përforcimit të kompetencave të tyre profesionale, qëllimi është të rriturit e trajnuar të jenë më efikas dhe kompetent në tregun e punës.

Afati: 2023  
Sektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e njohjes së mësimin paraprak të nxënë, e zhvillimit profesional dhe e trajnimit  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **PËRDITËSIMI I KATALOGUT TË PROGRAMEVE TË VERIFIKUARA PËR ARSIMIMIN E TË RRIURVE, OFRUESVE TË SHËRBIMEVE, SHPALLJEVE DHE INFORMACIONEVE TË TJERA PËR PUNËN VIJUESE TË QARR-it**

Qendra e Arsimimit të të Rriturve do të vazhdojë me përditësimin e katalogut për programet e veçanta të verifikuara për arsimimin e të rriturve që është i përpiluar për vitin 2012. Katalogu i përpiluar mundëson qasje në të dhënat për arsimin e të moshuarve të të gjitha palëve të interesuara: ofrues, pjesëmarrës dhe aktorë të tjerë kyç. Në korniza të katalogut tani janë përfshirë 747 programe të veçanta për arsimimin e të rriturve, të verifikuara nga ana e IP Qendrës së Arsimimit të të Rriturve - Shkup

Përditësimi i ueb faqes, organizimi i dokumenteve dhe i lëndëve, përpunimi dhe distribuimi, ruajtja, organizimi (përditësimi), vendosja, si dhe shpërndarja e të njëjtave. Gjithashtu sigurimi i vazhdueshmërisë së dokumenteve, menaxhimi i meta të dhënave dhe mbrojtja e informacioneve dhe dokumenteve nga qasja e paautorizuar.

Afati: 2023

Bartës: Njësia e çështjes financiare dhe materiale, punëve normative, juridike, administrative dhe mbështetjes informatike

Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **MBIKËQYRJA PROFESIONALE E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE**

### **Mbikëqyrja profesionale e ofruesve të shërbimeve**

Qendra e Arsimimit të të Rriturve kryen mbikëqyrje profesionale të punës së institucioneve, gjegjësisht të arsimimit të të moshuarve dhe vëzhguesve të procesit të trajnimeve të arsimimit të të rriturve. Gjithashtu QARR-i kujdeset edhe për plotësimin e procedurave për sigurimin e cilësisë dhe të qëndrueshmërisë së kriterëve të ofruesve të shërbimeve dhe në kohë të reagojë ndaj mospajtimeve të konstatuara në drejtim të zbatimit të trajnimit, kuadrit mësimdhënës, cilësisë së punës së ofruesve të shërbimeve. Drejtpërdrejt gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale QARR-i jep udhëzime për udhëheqje të rregullt të dokumentacionit dhe evidencës.

Bartës: Sektori i përgatitjes, i miratimit dhe i mbikëqyrjes profesionale të programeve arsimore të të rriturve - Njësia e mbikëqyrjes profesionale dhe e vlerësimit të programeve të arsimimit të të rriturve

Afati: 2023

Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

### **Bashkëpunimi i ofruesve të shërbimeve**

QARR-i vazhdimisht bashkëpunon me ofruesit e shërbimeve të arsimimit të të rriturve të cilët kanë verifikuar programe të veçanta për arsimimin e të rriturve dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve çfarë duhet të plotësojnë, në kuptimin e standardeve për hapësirën, pajisjen dhe kuadrin për të marrë verifikim. Gjithashtu, QARR-i jep udhëzime dhe rekomandime se si të udhëhiqen dokumentet dhe evidenca me të cilën udhëheqin ofruesit e shërbimeve.

Afati: 2023

Bartës: Sektori i përgatitjes, i miratimit dhe i mbikëqyrjes profesionale të programeve arsimore të të rriturve - Njësia e mbikëqyrjes profesionale dhe e vlerësimit të programeve për arsimimin e të rriturve

Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

## **BASHKËPUNIMI**

Qendra do të vazhdojë me krijimin dhe përforcimin e bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale, partnerët socialë dhe palët tjera kryesore të interesuara, në nivel nacional dhe ndërkombëtar.

### ***Identifikimi dhe zhvillimi i rrjetit të partnerëve ekonomikë dhe institucionalë***

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të aktiviteteve në kompetencë të tyre, Qendra e Arsimimit të të Rriturve do të vazhdojë me krijimin dhe përforcimin e bashkëpunimit të vetëqeverisjes lokale, partnerët socialë dhe palët e tjera kryesore të interesuara, në nivel nacional dhe ndërkombëtar.

Afati: 2023

Bartës: IP Qendra e Arsimimit të të Rriturve

### ***NPAA (PROGRAMI NACIONAL I HARMONIZIMIT TË LEGJISLACIONIT VENDAS ME TË TË DREJTËN E BASHKIMIT EUROPIAN)***

NPAA paraqet dokument kyç strategjik, i cili i përfshin prioritetet, dinamikën e miratimit të legjislacionit nacional me atë europian, si dhe përshtatja e institucioneve nacionale drejt strukturave europiane administrative.

Qendra e Arsimimit të të Rriturve i planifikon, përpilon dhe rregullisht i përditëson të dhënat e NPAA-së sa i përket arsimimit të të rriturve.

Afati: vijues

Sektori i avancimit të arsimimit të të rriturve - Njësia e sigurimit të cilësisë, e zhvillimit dhe e bashkëpunimit  
Mjete financiare: Buxheti i QARR-it

Programi vjetor i Qendrës së Arsimimit të të Rriturve u miratua më 4.1.2023

**KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES,  
Сашо Дукоски**